




REPUBLIKA E SHQIPÉRISË



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
LEZHË



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E DREJTÉSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 889 Prot.
Datë 01.12.2020

Nr. 458 Prot
Date 28.10.2020

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

DHE

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

« Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 « Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti » »

Sot, më datë _____ lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve :

Gjykatës së Rethit Gjyqësor Lezhë, me adresë : _____, përfaqësuar nga _____, këtu e në vijim « *Gjykata* ».

Dhe

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me adresë: Rr. Barrikadave, nd. Nr. 18, hyrja nr. 6, zyra nr. 10-3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z. *Ergys Qirici*, këtu e në vijim « *Drejtoria* ».

Duke qënë se Palët,

Vlerësojnë rëndësinë e sistemit të ndihmës Juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

Konsiderojnë se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Marrin në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Synojnë, implementimin efektiv të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, bazuar në parimin e:

- a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gjëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit;
- dh) shmangjies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

Konfirmojnë, angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta dhe për të adresuar nevojat e subjekteve përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017.

Njohin faktin se gjykatat janë aktorët kyç në garantimin e funksionimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore dhe se gjyakata ka disponibilitetin maksimal për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike dytësore sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit nr.111/2017.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmérinë pér tē bashkëpunuar dhe kontribuuar nē realizimin e qëllimit tē kësaj marrëveshje.

Kanë rënë dakord tē lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi nē vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje mes Palëve konsiston nē vendosjen e bashkëpunimit tē dy institucioneve sa i përket shërbimit tē ndihmës juridike tē garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave pér rrithjen c'akscit nē drejtësi tē qytetarëve dhe nē veçanti tē grupeve vulnerablebël.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet nē *nenin 2; nenin 4; nenin 6 shkronja “ç”;* *nenin 22; nenin 23* tē ligjit nr.111/2017 “Pér ndihmën juridike tē garantuar nga shteti”.

Neni 3
Qëllimi

Palët bien dakord tē bashkëpunojnë mbi:

- Ofrimin e shërbimit tē ndihmës juridike dytësore nga gjykata sipas përcaktimeve tē legjislacionit procedural nē fuqi ;
- Orientimin e subjekteve përfitues drejt sistemit tē ndihmës juridike tē garantuar nga shteti sipas përcaktimeve tē ligjit nr. 111/2017, « *Pér ndihmën juridike tē garantuar nga shteti* »;
- Promovimin e sistemit tē ndihmës juridike tē garantuar nga shteti përmes zhvillimit tē aktiviteteve tē përbashkëta sensibilizuese ; edukimit ligor apo afishimit tē materialeve tē vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojës nē kuadër tē përmirësimit tē politikave shtetërore nē fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve pér tē diskutuar çështjet me interes tē përbashkët;
- Bashkërendimin nē dhënien e informacionit mbi vendimet gjyqësore me objekt « *Kërkesë pér ndihmë juridike dytësore* » sipas Kreut V tē ligjit 111/2017 « *Pér ndihmën juridike tē garantuar nga shteti* » dhe udhëzimit tē përbashkët nr.17, datë 05.08.2020 « *Pe rregullat e zbatimit tē parimit tē rotacionit nē caktimin e avokatëve që do tē ofrojnë shërbime tē ndihmës juridike dytësore nē proceset civile dhe administrative* ».
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve tē përbashkëta nē këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve tē përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve tē karakterit ligor dhe administrativ dhe vënien e tyre nē

dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.

Neni 4
Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon :

Për Gjykatën : ORNELA NAQELLARI KRYETARE

Për Drejtorinë : Ergys Qirici, Drejtori Përgjithshëm

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënët e personit të ri të kontaktit.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 6
Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim finansiar ndaj palës tjetër.

Marrëvesha mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR

LEZHË

KRYETARE :

Ornela Naqellari



PËR DREJTORINË E NDIHMËS

JURIDIKE FALAS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici



Rr. e Barrikadave, Nd. 18, hyrja 6, zyra 10, kat 3, Tiranë